



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 24 Prill 2021

Nr: 43

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 24, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 24.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilijan RUSMALI	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Bindja Demokratike.

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 24, të partisë Bindja Demokratike me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 10, datë 23.04.2021 të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 29, qarku Tiranë dhe ndryshimin e vendimit nr.10, datë 21.04.2021 të KZAZ nr. 29 dhe pranimin e listës së vëzhguesve të Partisë Bindja Demokratike”.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



VËREN:

Subjekti ankues Partia Bindja Demokratike ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 24 regj., datë 24.04.2021.

Në mbledhjen e datës 24.04.2021, ora 19:00, pas relativitetit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa ankimore nr. 24, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronjat “a” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”,

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 24, datë 24.04.2021, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 24 Prill 2021, në orën 19:15.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjan RUSMALI - Relator

Elvin LAKO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

